



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

(Komisioni për hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat)

Datë: 19.01.2024

Procesverbal

I përpiluar me datë 19.01.2024 me rastin e mbajtjes së diskutimit publik me qytetar lidhur me hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi Tefik Maloku, kryetar i komisionit për hartimin e draftit të rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Te pranishëm në takim ishin 38 pjesëmarrës të cilët shprehen interesimin e tyre lidhur me këtë rregullore e të cilët parashtruan edhe pyetje për këtë çështje.

Taibe Krasniqi nga fshati Begaj pyeti se a do të ketë përkrahje për biznese dhe start ape të cilat udhëhiqen nga gratë.

Nagip Shala nga fshati Dobërllukë pyet se a ka mundësi që komuna të jap grande në blegtori me theks të veçantë lopë qumështore.

Mihasne Mehmeti nga fshati Oshlan, meqenëse ne kemi fermën e dhive dhe kemi nevojë për pajisje me makina për mjelje, a mundet komuna që te na ofrojë mbështetje qoftë financiare qoftë me pajisje/makina.

Avdurrahman Fazliu nga fshati Kollë shprehu shqetësimin e tij lidhur me aplikimin për subvencione të ministrisë e që aplikimi behet në komune ku kërkoj të krijohet një rregull me i mirë nga komuna duke mos krijuar tollovi para sporteve.

Blerimi nga Vushtrria shprehu shqetësimin e tij lidhur me aplikimin për grande me ministri ku po kanë problem me marrjen e lejes për ndërtimin e stallave ku kërkohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore e cila po u merr shumë kohë.

Bashkim Muli nga Vushtrria paraqiti problemin e njëjtë lidhur me lejet e ndërtimit për stallat.

Sabile Xhaka nga fshati Oshlan pyet se si mundemi me përfitua nga komuna si shoqatë.

Ndërsa Bashkim Gashi nga Vushtrria ne pamundësi te jete i pranishëm ne takim, përmes telefonit komentoj lidhur me një gabim teknik që është lëshuar nga ana e komisionit në nenin 20 paragrafin 1 lidhur me afatin për lidhjen e kontratës në mes përfituesit dhe komunës.

Sa i përket draft-rregullores nuk pati ndonjë vërejtje apo propozim konkret por pjesëmarrësit më shume ishin të fokusuar se si do te përfitojnë nga fondet publike që ndahen për këto kategori.

Proces mbajtjesi Fatmir Feka_____

Verifikuar nga : Tefik Maloku_____

Liridon Lahu_____